



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 23 të Rregullores së Brendshme Nr. 02/2024, Për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Grupit të Gjashtë të Pozitave sipas Departamenteve, për Angazhimin e Stafit jo Permanent

- I. Miratohen grupi i gjashtë i pozitave sipas departamenteve, për angazhimin e stafit jo permanent, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Lista me pozita si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.12.2024





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

FAZA E GJASHTË E REKRUTIMIT TË PERSONELIT TË PËRKOHSHËM

Nr.	Angazhimi i personelit të përkohshëm për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 - Grupi i gjashtë	Nr. i personelit
1.	Zyrtar i Teknologjisë Informative në KQZ – staf shtesë	3
2.	Zyrtar për Komunikim dhe Shërbim për Votues - staf shtesë	5
3.	Udhëheqës i Ekipit në QNR	1
4.	Receprionist në QNR	2
5.	Staf Teknik dhe Mirëmbajtës – staf shtesë	2
6.	Zyrtar i Logjistikës në Depo / QNR	18
7.	Zyrtar për Transport – staf shtesë	2
8.	Zyrtar Mbështetës Financiar	2
		35





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1. i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloren Zgjedhore nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Kërkesës dhe Specifikimeve për Shërbimet Postare për Votimin Jashtë Kosovës

- I. Miratohet kërkesa dhe specifikimet për shërbimet postare për Votimin Jashtë Kosovës për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me 9 shkurt 2025.
- II. Kërkesa dhe specifikimet si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.12.2024





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1. si dhe nenin 87 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloren Zgjedhore Nr.10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat, si dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Kërkesës dhe Specifikimet për Shtypjen e Fletëvotimeve, Broshurave dhe Listave Votuese

- I. Miratohet kërkesa dhe specifikimet për shtypjen e fletëvotimeve, broshurave dhe listave votuese për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me 9 shkurt 2025.
- II. Kërkesa dhe specifikimet si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.12.2024

Kreshnik RADONIQI
Kryesuesi i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 98 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 7 i Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, me datën 30.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Refuzimin e Kundërshtimit Administrativ

- I. Miratohet rekomandimi i datës 29 dhjetor 2024, për refuzimin e kundërshtimit administrativ i komisionit për kundërshtim administrativ, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të datës 09 shkurt 2025.
- II. Lista me të dhënat e aplikuesve për refuzimin e kundërshtimit administrativ si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet komisioni të njoftoj palën ankuese.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Lidhur me kundërshtimet administrative, të paraqitur pas mbylljes së afatit për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës, Komisioni ka konstatuar se aplikuesit nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara për tu regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës.

Aplikimi për regjistrim përmes sistemit elektronik nuk është bërë në përputhje me kriteret e Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimit Jashtë Kosovës.

Refuzimi i kundërshtimit është bazuar në nenin 3, të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimit Jashtë Kosovës, ku thotë se *“Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet duke plotësuar dhe bashkangjitur:*

- *Të dhënat në formularin elektronik për regjistrim (duke përfshirë email adresën);*
- *kopjen e njërit prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi;*
- *verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit - **aplikuesi ngarkon fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës;***

- Në rast se dokumenti identifikues i lëshuar nga Republika e Kosovës është me afat të skaduar, duhet bashkëngjitur edhe një kopje e dokumentit të vlefshëm të identitetit të shtetit në të cilin jeton”

Andaj, meqenëse në periudhën e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk janë zbatuar kriteret e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë ankese në PZAP, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i pranimit të vendimit të KQZ-së.

Prishtinë, 30.12.2024





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 dhe nenin 98 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloren Zgjedhore Nr.17/2024 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, me datën 30.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Kundërshtimi Administrativ dhe Përfshirjen e Aplikuesve për Regjistrim për Votim Jashtë Kosovës

- I. Miratohet kundërshtimi administrativ dhe përfshirja e aplikuesve për regjistrim për votim jashtë Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të datës 09 shkurt 2025.
- II. Lista me të dhënat e aplikuesve si në pikën I të cilët që do të përfshihen në listën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet komisioni të njoftoj palën ankuese.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.12.2024

Kreshnik RADONIQI
Kryesuesi KQZ